



SISTEMI FOLJOR I NDRE MJEDËS

Fitore Imeri,

Kolegji Globus, Prishtinë

Abstrakt:

Duke folur për Ndre Mjeden dhe rolin e tij në gjuhën shqipe, Kolec Topalli do të çilesonte atë si një artist të fjalës dhe njohës i mirë i gjuhës, levrues i rrallë i saj dhe gjuhëtar me vlera të mëdha. "Në veprën e tij, vijoi Topalli, gërshetohet mjeshteria poetike me gjuhëtarin e shquar, duke dhënë shembullin e përdorimit të saktë të gjuhës, me ndërtim fjalësh e sintagmash, sipas natyrës së shqipes, të cilat mund të gjejnë shumë lehtë udhën për t'u përdorur në ditët e sotme".

Kumtesa e prof. dr. Kolec Topallit, "Ndre Mjeda dhe pasurimi i gjuhës shqipe" ishte e mbushur me shembuj konkretë të përdorimit të gjuhës nga poeti i shquar, interpretimi i të cilave në auditor nga kumtuesi krijoi emocione për të pranishmit. "E gjithë kjo pasuri gjuhësore e veprës së këtij poeti të talentuar, që nuk është përfshirë në Fjalorin e Gjuhës së Sotme Shqipe, mund të rigjallërohet, duke pasuruar gjuhën e sotme shqipe, që sipas shprehjes së Bardhit, "po prishet e po bastardohet sa ma parë të ve". Ndërsa, duke iu referuar veprës poetike, Kolec Topalli tha se "te Mjeda gjejme jo vetëm fjale të shqipes, të përdorura me mjeshtëri dhe elegancë, por edhe forma gramatikore me vlera të vecanta, sintagma dhe frazeologji, që i japin gjuhës së këtij artisti zhërvjelltesë të vecante dhe thellesë mendimi, që jepen me fjale të pakta". Topalli shtoi se "në të gjendet shkurtësia e shprehjes, lakonizmi, ekonomia gjuhësore, të cilat poeti i mori në të folmen e vendlindjes dhe i përpunoi me tej".



HYRJE

Gjuha shqipe ndodhet sot para sfidash te medha. Hapja e Shqiperise mbas vitit 1992, zhvillimet e reja ekonomike e shoqerore, globalizmi kulturor, emigracioni masiv, ndikimet e shumta te gjuheve romane e anglosaksone, si dhe faktore te tjere te jetes ne komunitete te hapura, e kane vene shqipen para udhekryqesh te veshtira. Këto lidhen sidomos me rruget e pasurimit dhe te ruajtjes se sistemit te saj gramatikor. Zhvillimi i metejshem i gjuhes eshte nje proces i pandalshem, por rruget, qe do te ndiqen, duhet te lidhen me nevojen per te ruajtur strukturen dhe tiparet e saj, duke perpunuar sidomos brumin e vete gjuhesor, per t'ia pershtatur situatave dhe kushteve te reja". Per kete - u shpreh Topalli - eshte e nevojshme qe here pas here t'i drejtohem i mjeshterve te medhenj te gjuhes shqipe, per te nxjerre prej veprave te tyre thesarin leksikor, forma e shprehje te bukura, qe mund te perdoren edhe ne gjuhen e sotme. Njeri nder ta eshte pa dyshim Ndre Mjeda".

Duke folur per Ndre Mjeden dhe rolin e tij ne gjuhen shqipe, Kolec Topalli do ta cilesonte ate si nje artist te fjales dhe njohes i mire i gjuhes, levrues i rralle i saj dhe gjuhetar me vlera te medha. "Ne vepren e tij, vijoi Topalli, gershetohet mjeshteria poetike me gjuhëtarin e shquar, duke dhene shembullin e perdorimit te sakte te gjuhes, me ndertime fjalish e sintagmash, sipas natyres se shqipes, te cilat mund te gjejne shume lehte udhen per t'u perdorur ne ditet e sotme".

Kumtesa e prof. dr. Kolec Topallit, "Ndre Mjeda dhe pasurimi i gjuhes shqipe" ishte e mbushur me shembuj konkrete te perdorimit te gjuhes nga poeti i shquar, interpretimi i te cilave ne auditor nga kumtuesi krijoi emocione per te pranishmit. "E gjithë kjo pasuri gjuhesore e vepres se ketij poeti te talentuar, qe nuk eshte perfshire ne Fjalorin e Gjuhes se Sotme Shqipe, mund te rigjallerohet, duke pasuruar gjuhen e sotme shqipe, qe sipas shprehjes se Bardhit, "po prishet e po bastardohe sa ma pare te ve". Ndersa, duke iu referuar vepres poetike, Kolec Topalli tha se "te Mjeda gjejme jo vetem fjale te shqipes, te perdurura me mjeshtri dhe elegance, por edhe forma gramatikore me vlera te vecanta, sintagma dhe frazeologji, qe i japin gjuhes se ketij artisti zhdervjelltesi te vecante dhe thellesi mendimi, qe jepen me fjale te pakta". Topalli shtoi se "ne to gjendet shkurtesia e shprehjes, lakonizmi, ekonomia gjuhesore, te cilat poeti i mori ne te folmen e vendlindjes dhe i perpunoi me tej". Nje tjetër element, qe u evidentua ne kumtesen e zotit Topalli, ishte ajo qe ne format e shumesis, ndonje trajte e perdorur nga poeti dhe ne pergjithesi nga dialekti geg, mund te integrohet ne gjuhen shqipe te sotme, pasi e ka me te qarte funksionin e dallimit te kategorive gramatikore te numrit. Per sistemin foljor, Topalli thote se, "Mjeda perdor me mjeshtri format e pjesores, qe shprehin me nje menyre te shpejte e me nje fjale te vetme gjendje te caktuara. Po keshtu, nje mori ndertimesh te larmishme gjenden ne vepren e Mjedes edhe ne fushen e ndajfoljeve, ku poeti perdor per kete qellim mbiemra me prapashtesen "shem", pak te njohur ne shqipen e sotme, ku ka madje shpeshhere shkaterrime e keqperdorime te tyre, edhe si mbiemra, duke u perdorur mbiemrat pjesore ne vend te tyre". Kumtuesi Kolec Topalli



evidenton se ne vepren e Ndre Mjedes, qe eshte nje njohes dhe levrues i mire i gjuhes, gjenden edhe mjaft fjale qe nuk njihen ose jane pak te njohura ne shqipen e sotme. "Por ato do te ishin per te nje pasuri me shume", thekson Topalli. Ai permend emrat "hae" per ushqim, "ndeje" per banese, "trame" per frike, "gjashtore e kacatore" per lloje armesh, "shpuer" per vrime, "ndale" per pengese, etj.

KUPTIMET KRYESORE TË FORMAVE GRAMATIKORE TË FOLJES MËNYRA DËFTORE

Me anë të kësaj mënyre, folësi e paraqit si të vërtet veprimin e emëruar nga folja. E, ku folësi dëshiron ta mohojë ose të shprehë pasiguri për këtë vërtetësi, atëherë e shoqëron foljen e mënyrës dëftore me pjeëzat e mohimit *nuk, a s'*, përkatësisht me pjesëzat e dyshimit *ndoshta, mbase, kushedi* etj.

Mënyra dëftore, i ka të tri kohët themelore, nga të cilat e shkuara ka pesë nëndarje kryesore: të pakryerën, të kryerën e thjeshtë, të kryerën, më se të kryerën dhe të kryerën e tejshkuar, kurse e ardhmja ka katër nëndarje: *të ardhmen, të ardhmen e përparme, të ardhmen e së shkuarës dhe të ardhmen e përparme të së shkuarës.*

Koha e tashme.- Kuptimi themelor i foljes në kohën e tashme të mënyrës dëftore është të tregojë kryerjen e një veprimi në një kohë që përfshin edhe çastin e ligjërimit. Por, siç do të shtjellohet edhe më poshtë, ajo përdoret edhe me një kuptimi mbarëkohor e në disa rrethana edhe me kuptimin e së ardhmes dhe të së shkuarës.

Kur përdoret në kuptimin themelor të kohës së tashme, foljet shoqërohen zakonisht me pjesëzën *po*. Kjo i jep mundësi foljes në kohën e tashme të tregojë një veprim të caktuar, që vazhdon të zhvillohet në çastin e ligjërimit. Po me këtë kuptim und të përdoret edhe forma perifrastike e ndërtuar me anë të kohës së tashme të ndihmëses jam dhe përcjellores së foljes.

Po shkrihet bora,

Dimri po shkon;

Bylbyl i vorfën,

Pse po gjimon? (Mjeda, N., 2002, Vepra letrare, Juvenilja, fq. 6)

Nër pyje e orgaja,

N'ma tmirin vend,

Me rreze dielli

Po e gëzon gjithkënd. (Mjeda, N., 2002, Vepra letrare, Juvenilja, fq. 6)



SISTEMI FOLJOR I NDRE MJEDËS

Fitore Imeri,

*Po shkrihet bora,
Dimni po shkon;
Bylbyl i vorfën,
Pse po gjimon? (Mjeda, N., 2002, Vepra letrare, Juvenilja, fq. 6)*

*A thue po kjan, se çedhen
Ta ka shkatrrue skyfteri?
A thue po kjan, o i mjeri,
Se me rrnue gjallë s'ke mel? (Mjeda, N., 2002, Vepra letrare, Juvenilja, fq. 6)*

Disa folje që emërojnë veprime ose gjendje që e karakterizojnë kryefjalën për një kohë të pacaktuar, nuk shoqërohen me pjesëzën po. Të tilla janë foljet *dua, di, dashuroj, urrej, kam, jam, gjendem, ndodhem, nxë, përmban, ngërthen etj.*

Disa folje, që emërojnë veprime, sidomos veprime sidomos veprime fizikofiziologjike, përdoren rëndom, sidomos në fjalitë pytëse, pa pjesëzën *po*, edhe kur është fjala për veprime të caktuara. Kjo ndodh, për arsye se me anë të fjalive të tilla pyesim zakonisht për veprime të caktuara. Megjithatë, kur duam ta përcaktojmë më mirë kuptimin kohor të së tashmes, mund ta përdorim fare natyrshëm pjesëzën *po*.

*Po shkrihet bora,
Dimri po shkon;
Bylbyl i vorfën,
Pse po gjimon? (Mjeda, N., 2002, Vepra letrare, Juvenilja, fq. 8)*

*Athue po kjan, se çerdhen
Ta ka shkatrrue skyfteri?
A thue po kjan, o i mjeri,
Se me rrnue gjallë s'ke mel? (Mjeda, N., 2002, Vepra letrare, Juvenilja, fq. 8)*

*Veç ti me idhnime t'tuja
N'zemër gjithmonë po pihe,
E ditë e natë po shkrihet
Mbas vajit që t'mundon. (Mjeda, N., 2002, Vepra letrare, Juvenilja, fq. 9)*

*Moj dallëndyshe shtegtare e rmyeshme,
Që po pshtete n'at balkue,
Për gjith nadje 'j kangë t'mallënjyeshme
Aq përmallshëm tuj këndue;*



SISTEMI FOLJOR I NDRE MJEDËS

Fitore Imeri,

*Ç' do me mthanë n' atë gjuhë vajtores,
Moj dallëndyshëza shtegtore? (Mjeda, N., 2002, Vepra letrare, Vaji i dallëndyshes, fq. 62)*

*Po pse me dorë katile
Un' shokut due me i ra?
O zemër, pse iu çile
Nji mnis' që s' don m' u nda? (Mjeda, N., 2002, Vepra letrare, Mos i bje shoqit, fq. 128)*

*E krahit tem fuqia
A kështu do t' përdoret,
A forca kambve t' mia
Me shqelma do t' turpnohet? (Mjeda, N., 2002, Vepra letrare, Mos i bje shoqit, fq. 128)
A thue jam shtazë me brina?
Po shpirti a thue m' ka ikë,
Që n' kët sahat un' mbrina
Shokun t' mendoj m' e frikë? (Mjeda, N., 2002, Vepra letrare, Mos i bje shoqit, fq. 128)*

Kur përdoret me kuptim mbarëkohor, folja në kohën e tashme nuk shoqërohet me pjesëzën po. E përdorur kështu, ajo mund të tregojë:
Veprime të zakonshme, që përsëriten herë pas here:

*Bab' e nan' sa kemi derdhë
Mbi shteg tem e hire e dritë.
Ah! Sa mirë m' keni gatitë
Për çdo koh' e për çdo vend. (Mjeda, N., 2002, Vepra letrare, Dashtnia ndaj prindes, fq. 129)*

Veprime që nuk lidhen me një kohë të caktuar, sepse kanë vlerë mbarëkohore. Një përdorim i tillë i së tashmes vihet re sidomos në fjalët e urta popullore (proverbat) dhe në aksiomat shkencore, në të vërtetat e përgjithshme, ku bëhen pohime, që kanë vlerë për çdo kohë, pra, edhe për çastin e ligjërimin.

E tashmja e mënyrës dëftore mund të përdoret edhe me kuptimin e së ardhmes, kur në fjali ka tregues kohorë, që shënojnë të ardhmen, *si nesër, pasnesër, pas një ore* etj. Në këtë përdorim folja në kohën e tashme nuk shoqërohet me pjesëzën po, megjithatë shenjon veprime të caktuara: - *Dëgjo këtu, nesër na vjen uji te dera e do të gëzohemi.*

Me kuptimin e së shkuarës koha e tashme e mënyrës dëftore përdoret në këto dy raste:



SISTEMI FOLJOR I NDRE MJEDËS

Fitore Imeri,

Kur duam që një veprim a ngjarje, që ka marrë fund në të shkuarën, ta paraqitim sa më të gjallë, sikur të ndodhte para syve tanë. Në këtë rast ajo quhet e tashme historike, sepse përdoret me vlerën e së shkuarës.

Kur folja tregon një veprim që ka nisur në të shkuarën dhe vazhdon edhe në çastin e ligjërimin. Në këtë rast e tashmja, e përdorur me vlerën e kohës së kryer, plotësohet nga një tregues kohor, që tregon cakun e fillimit të veprimit të emëruar nga folja. Në këtë përdorim folja në kohën e tashme zakonisht nuk shoqërohet me pjesëzën po.

Veta e parë shumës e kohës së tashme të dëftores përdoret edhe me vlerën e mënyrës lidhore për të shprehur një propozim, këshillë, nxitje etj.

Nji shoq po i thotë nji ditë;

Bashkë do t'kalojmë' n'qytet;

Katundi fort t'mërzit

E shpesh me hangër s'qet:” (Mjeda, N., 2002, Vepra letrare, Mini, fq. 146)

Koha e shkuar.- Nga pesë nëndarjet kryesore të kohës së shkuar, e pakryera, e kryera e thjeshtë dhe e kryera zakonisht tregojnë veprime të përfunduara para çastit të ligjërimin. Kurse më se e kryera dhe e kryera e tejshkuar tregojnë veprime të përfunduara para çastit të caktuar të së shkuarës. Këto formime kohore dallohen midis tyre edhe nga ngjyrimet aspektore, për të cilat do të bëhet fjalë në paragrafët përkatës.

E pakryera.-Kuptimi themelor i së pakryerës është të tregojë një veprim në zhvillim e sipër në cast të caktuar të së shkuarës. Por ajo përdoret edhe me kuptime të tjera, për të cilat do të bëhet fjalë më poshtë. Në lidhje me çastin e ligjërimin, veprimi i shprehur nga folja në të pakryerën është përfunduar, por kjo gjë kuptohet vetëm nga konteksti, sepse vetëm folja në këtë rast nuk tregon gjë as për mbarimin, as për fillimin e veprimit të emëruar prej saj.

Kur përdoret në kuptimin themelor të së pakryerës, folja (me disa përjashtime për të cilat shoqërohet zakonisht me pjesëzën *po*. Kjo i jep mundësi foljes në të pakryerën që të tregojë një veprim të caktuar, që ishte duke u zhvilluar në një cast të caktuar të së shkuarës, i cili shënohet zakonisht me anë të një treguesi kohor (rrethanor kohe ose fjali e varur kohore). Po me këtë kuptim mund të përdoret edhe forma perifrastike e ndërtuar me anë të së pakryerës së foljes ndihmëse jam dhe përcjellores së foljes.

Prej çardakut nalt e pa

Edhe ujkun tuj u sjellë,

E me gaz filloi me e sha:



SISTEMI FOLJOR I NDRE MJEDËS

Fitore Imeri,

“*Qe, ka dalë maloku n’diell*”. (*Mjeda, N., 2002, Vepra letrare, Edhi dhe ujku, fq. 158*)

Pjesëzat *po* në kohën e pakryer përdoren më pak se në kohën e tashme,

E pakryera e dëftores përdoret, ndër të tjera, edhe me këto kuptime:

Për të treguar një veprim të pacaktuar, që është përsëritur herë pas here në të shkuarën. Kuptimi i përsëritjes del nga konteksti. Në raste të tilla folja në të pakryerën plotësohet shpesh nga tregues kohorë, që e bëjnë të qartë përsëritjen e veprimit. Këta tregues kohorë mund të jenë:

Një rrethana e kohe që tregon një fraksion a periudhë kohe, që përsëritet rregullishtë, si: çdo mëngjesë, çdoditë, çdojavë, çdovit, herpashere:

Një fjali e varur, kryesisht kohore (por edhe vendos, shkakore etj), që ka si kallëzues një folje *po* në të pakryerën e dëftorës.

Për të treguar një veprim të pacaktuar, që ka zgjatur për një kohë pak a shumë të gjatë në të shkuarën.

E pakryera e dëftorës përdoret edhe sit ë tashme në të shkuarën. Në këtë rast ajo emëron një veprim, që në një cast të dhënë të së shkuarës është shprehur me kohën e tashme. Kjo ndodh atëherë kur një fjali të ligjëratës së drejt me folje-kallëzues në të tashmën e dëftorës e kthejmë në një ligjëratë të zhdrejtë, duke shëndrruar kështu në një fjali të varur nga folje të tilla si: them, pyes, përgjigjem etj., në një nga kohët e së shkuarës, kryesisht në të kryerën e thjeshtë ose në të pakryerën. Një zëvendësim i tillë i së tashmes me të pakryerën mund të ndodhë edhe atëherë kur fjalitë, me të cilat përshkruhet një peisazh, kthehen në fjali të varura nga një fjali tjetër, në të cilën folja është në një nga kohët e së shkuarës. Në këto raste e pakryera e ruan pjesëzën *po*, në këtë rast se e ka pasur koha e tashme e ligjëratës së drejt.

E pakryera e foljeve *jam* dhe *kam* përdoret jo rrallë edhe me kuptimin e së kryerës së thjeshtë;

Në gjuhën popullore, aty-këtu edhe në gjuhën letrare, e pakryera e dëftorës përdoret jo rrallë edhe me vlerën e mënyrës kushtore nëpër apodosa periudhash hipotetike: *Të mos kasha ata kalamaj, që po më hanë sytë, shkoja (do të shkoja) edhe unë atje.*

E kryera e thjeshtë.- Kuptimi themelor i së kryerës së thjeshtë është të tregojë një veprim të përfundur në një cast të caktuar të së shkuarës. Pra ndryshimi i kësaj kohe nga e pakryera ka më fort karakter aspektor.

Por e kryera e thjeshtë në gjuhën shqipe, ashtu si koha e tashme, përdoret edhe me një kuptim mbarëkohor e në disa rrethana edhe me kuptimin e së ardhmes.



SISTEMI FOLJOR I NDRE MJEDËS

Fitore Imeri,

Folja e përdorur me kuptimin themelor të së kryerës së thjeshtë zakonisht shoqërohet me tregues kohorë, që shënojnë një kohë të caktuar të së shkuarës dhe që përjashtojnë kështu çastin e ligjëritimit. Të tillë tregues kohorë janë: psh. : ndafoljet e kohës dje, *pardje*, *vjet*, *parvjet*, *atëherë* etj., ose togfjalëshat me kuptim kohor të tipit *atë ditë*, *atë vit*, *para dy ditësh*, *para një jave* etj.

*E njat tok' që je tue gzue,
e ke zan' tash sa mij' vjet,
shqiptaria, që mbet mblue
sot nën dhe, edhe shqip flet. (Mjeda, N., 2002, Vepra letrare, Gjuha Shqype, fq. 55)*

*"Oh nane shkreta" - i shuemi briti
e permbyes u leshu mb'nji curr
"qe 3 vjet e shkreta m'priti
e tashma nuk me shef ma kurr" (Mjeda, N., 2002, Vepra letrare, Vllavrasi, fq. 65)*

*Vrojta 'i halë, s' cillës i kercnohen
Diell e borë e erë e shi:
Rrajtë e saja vec forcohen
E kahë qiella ajo lshon shtat;
Qinda **vjets**h kjo pau duhi,
Por duhija c' i ban s' pat. (Mjeda, N., 2002, Vepra letrare, Bukuri e virtyt, fq. 65)*

Kur duam të vëmë në dukje se veprimi i përfunduar në të shkuarën ka zgjatur njëfarë kohe, atëherë e shoqërojmë foljen me tregues kohorë të tillë si *kurrë*, *tërë jetën* etj., ose e përsëritim atë.

*C' at ditë qi e bora, mue s' m' knaqë natyra,
Nder gzime t' shekllit nuk m' qeshet ftyra;
Kurr s' m' hiqet mendjet kur nana m' tha:
T' laca me Zotin! - e diq e m' la. (Mjeda, N., 2002, Vepra letrare, Djali pa nënë si nata
pa henë Bukuri e virtyt, fq. 96)*

*Ndër komb' tjera, ndër dhena tjera,
ku e shkoj **jetën** tash sa mot,
veç për ty m'rreh zemra e mjera
e prej mallit derdhi lot. (Mjeda, N., 2002, Vepra letrare, Gjuha Shqype, fq. 55)*

Me tregues kohorë të tipit sot, sivjet, këtë javë etj., që përfshijnë edhe çastin e ligjëritimit, e kryera e thjeshtë mund të përdoret atëherë, kur folësi vë në dukje vetëm përfundimin e veprimit, pa e lidhur këtë me çastin e ligjëritimit:



*T' biemit t' kunorës s' shugrueme,
Prûjshem ndëroj e ruejti ;
Sot pushka e jote t' shuejti,
O i mjerë, gjallimin, (Mjeda, N., 2002, Meryling)*

Me kuptim mbarëkohor e kryera e thjeshtë përdoret për të shprehur mendime me vlerë të ngahershme. Një përdorim i tillë ndeshet nëpër fjalë të urta popullore. Në këtë rast zhduket dallimi kuptimor midis së kryerës së thjeshtë dhe së tashmes me kuptim mbarëkohor dhe, si rrjedhim, ato në disa raste mund të zëvendësojnë njëra-tjetrën.

Me kuptimin e së ardhmes e kryera e thjeshtë përdoret:

Kur folësi një veprim që s'ka nisur ende ose që është në zhvillim e sipër, e quan dhe e paraqit si një fakt që do të vërtetohet së shpejti, pra, si një fakt të kryer.

Në fjali të varura kushtore, të ndërhuara me lidhëzën nënrënditëse po. Në këtë përdorim ajo është sinonime me të tashmen e lidhorës. Në raste të tilla në fjalinë drejtuese folja është në mënyrën urdhërore ose në të tashmen a në të ardhmen e dëftorës, por mund të jetë edhe në të kryerën e thjeshtë të përdorur me kuptimin e së ardhmes.

Siç vihet re në mënyrën urdhërore, në numrin shumës shfaqet një temë më e zgjeruar, me -jë. Numri njëjës përputhet në temë me format e sotme, megjithëse vihet re zanojra e gjatë që mendojmë se është shprehje dialektore.

Të kryerën e thjeshtë e gjejmë të përdorur edhe me kuptimin e kohës së kryer: - **erdha** (**kam ardhur**) të punojë këtu në Maliq. **Më thanë (kanë thënë)** se keni kërkuar një mësues.

*"Vella" - i pergjegji zemerveshtiri,
njiktu t'vrava e njiktu po vdes
nuk kam sy me me pa ma nieri
bashke me ty ketu po mbes (Mjeda, N., 2002, Vepra letrare, Vllavrasi, fq. 65)*

*- C' farë sokolit thue, moj nanë?
T' thacë, moj, t' thacë se s' m' a ban ndera,
S' m' a ban shpija, as s' m' a ban dera
Me luejtë mendsh, moj nanë, mas kuej:
S' i kam dhanë, jo, fjalë kurrkuej.
E po t' tham: Se n' t' endun t' motit,
Po t' tham, po, me besë të Zotit,
Ty due fjalët me t' i ndigiue,
As s' kam mend me t' u largue.
Zemren dysh un s' mund e daj:
M' len t' qindisi, m' len të kja! -(Mjeda, N., Grueja shqyptare (Amë e bi))*



SISTEMI FOLJOR I NDRE MJEDËS

Fitore Imeri,

Për përdorimin e së kryerës së thjeshtë në vend të së kryerës së tejshkuar në fjalitë e varura kohore, të lidhura me anë të lidhëzave nënrënditëse *si, pasi*.

Në vend të së kryerës së thjeshtë të foljeve *jam* dhe *kam* përdoret aty-ktu e pakryera e tyre. Kjo dukuri do shpjeguar më fort me faktin se këto dy folje tregojnë një gjendje, që e karakterizon kryefjalën për një kohë të gjatë. E meqë e kryera e thjeshtë, si rregull, vë në dukje vetëm përfundimin e një veprimi, por jo zgjaturitë e tij, te këto dy folje ajo prirje të zëvendësohet nga e pakryera. Por, jo rrallë, vihet re edhe dukuria e kundërt, që mund të shpjegohet me paqartësinë e ndjenjës gjuhësore në përdorimin e këtyre foljeve në këto dy kohë.

Merr pelhuren, qi pat [=ka] enë

Bija e sajë; kishte pasë kenë

Kuq e zi e m' te qindisë

Gjet dashtnin qi e kisht' molisë.

N' krye t' flamurit kisht' punue,

Per rreth shqypje, m' dorë prarue,

Fjalët e hershme, fjalët e të Parve:

Se Shqypnia asht e Shqyptarve;

E nder skaje fjalët "liri".

Merr nanë-shkreta e pshtuell at bi,

Qi, pa njoftët tjetër dashtni,

Ishte [=qe] shkri vec per Shqypni. -(Mjeda, N., Grueja shqyptare (Amë e bi))

"T'kishe dekë ma mirë, o i mjerë -

thotë sa herë, -

Afër nanës qe [= ishte] t'desh e t'ruejti;

t'kishe mbyllë me duer te mia

këtu te shpia

njata sy qe [= ishte] mordja shuejti (Mjeda, N., 2002, Vepra letrare, I tretuni, fq. 15)

E kryera.- Kuptimi themelor i së kryerës së mënyrës dëftore është të tregojë një veprim të përfunduar, që nuk ka këputur lidhjet me çastin e ligjërimit. Si rrjedhim, nëpërmjet kësaj kohe, krahas përfundimit të veprimit, folësi vë në dukje edhe pasojat e tij në çastin e ligjërimit. E pikërisht ketu qëndron ndryshimi themelor i kësaj kohe nga e kryera e thjeshtë, nëpërmjet së cilës, folësi synon të vërë në dukje vetëm përfundimin e veprimit në një cast të caktuar të së shkuarës.

Në kuptimin e saj themelor e kryera përdoret:

Kur veprimi i përfunduar lidhet me çastin e ligjërimit nëpërmjet pasojave të tij. Në këtë rast ajo: a) Mundë të mos shoqërohet me asnjë tregues kohorë:



SISTEMI FOLJOR I NDRE MJEDËS

Fitore Imeri,

*Veç prej plehut gjel-kokoti
me njat za që s'nd'rron kurr-herë,
ka me gjegjë se a tue ndërrue moti
se a tue çue një tjetër erë. (Mjeda, N., 1999, Juvenilja dhe vjersha të tjera, Tiranë, fq.
37)*

*E vojt n'dritare prap. Ndoshta begu
ka mbërri te rruga e pret te shtegu
veshun me t'arta, mbi 'j pullali
për bukuri. (Mjeda, N., 1999, Juvenilja dhe vjersha të tjera, fq. 42)*

Mund të shoqërohet me një tregues kohor, që shenjon një periudhë të caktuar kohe, e cila përfshin edhe çastin e ligjërit, si: sot, sivjet, këto ditë, këtë javë, këtë muaj, këtë ditë etj. ; që dije, që vjet, që atëherë, që atë ditë, që atë javë (e gjerë më sot). **Sot me njatë dorë mizore,**
*Gjaksi i vetvedit, fike
Jeten, qi dor ' anmike,
O çet ' e trueme (Mjeda, N., 2002, Meryling)*

*T ' biemit t ' kunorës s ' shugrueme****,
Prûjshem ndëroj e ruejti ;
Sot pushka e jote t ' shuejti,
O i mjerë, gjallimin, (Mjeda, N., 2002, Meryling)*

mund të shoqërohet me një tregues kohor me kuptim kohor të pacaktuar, si: gjithëmonë, gjithënjë, kurdoherë, shpesh, dendur, herë pas here, kurrë etj.

*- Po cka kje qi lodt t' i xori?
Ku kje dhima, a ku kje zori?
A por, drue, mos m'je harlisë,
Qysh se kjan - o tuj qindisë.
Pasha nanen nuk mund t' bari,
Qi të me ndezet bija zhari!
Do t' a dije e zeza nanë,
Pse ti vetllat **shpesh** m' i vranë;
Pse c' kah mot, moj, buza s' t' qeshet
E n' argtime zemra s' t' ndeshet. -(Mjeda, N., Grueja shqyptare (Amë e bi))*

Kur veprimi në të shkuarën vazhdon ende në çastin e ligjërit. Ky kuptim i së kryerës del nga konteksti, ku mund të ketë edhe tregues kohorë, që tregojnë pikënisjen e veprimit ose



SISTEMI FOLJOR I NDRE MJEDËS

Fitore Imeri,

gjithë kohën që nga fillimi i veprimit e gjerë në çastin e ligjërit. Në këtë kuptim mund të përdoret edhe koha e tashme e dëftorës.

E kryera e mënyrës dëftore përdoret nganjëherë edhe me kuptimin e së kryerës së thjeshtë dhe të së ardhmes.

Me kuptimin e së kryerës së thjeshtë, d. m. th për të treguar vetëm përfundimin e një veprimi, pa vënë në dukje lidhjen e tij me çastin e ligjërit, koha e kryer haste kryesisht në gjuhën e folur, por aty-këtu edhe në gjuhën e shkruar.

- *Fol, moj bi, mos m' len nder grepa,*

Mos më mshef gja, moj, se do djepa

I kam luejtë [=luajta] der tash e m' ke

Dhelpen t' vjeter: Ty sot be

T' paca lshue, tash me m' diftue,

Se pse zemra peshë t'asht cue. -(Mjeda, N., Grueja shqyptare (Amë e bi))

- *C' farë sokolit thue, moj nanë?*

T' thacë, moj, t' thacë se s' m' a ban ndera,

S' m' a ban shpija, as s' m' a ban dera

Me luejtë mendsh, moj nanë, mas kuej:

S' i kam dhanë [= dhash], jo, fjalë kurrkuej. -(Mjeda, N., Grueja shqyptare (Amë e bi))

Kurse me kuptimin e së ardhmes e kryera, ashtu si e kryera e thjeshtë, përdoret atëherë kur folësi e paraqit si një fakt të kryer një veprim, që s'ka nisur ende.

Për s ai takon së kryerës së dytë, kjo ka një kuptim të ngjashëm me atë të së kryerës, veçse përdoret zakonisht për veprime të një të shkuare të largët: Në Elbasan u kanë pasë thënë surreta.

Më se e kryera.-Kuptimi themelor i më se të kryerës është të tregojnë një veprim të përfunduar para një çasti të caktuar të së shkuarës. Ky veprim i përfunduar mund të lidhet me çastin e caktuar të së shkuarës nëpërmjet pasojave ose vijimit gjer në atë cast ose mund të mos ketë lidhje me çastin e caktuar të së shkuarës.

Si në rastin e parë ashtu edhe në rastin e dytë, kuptimi i më se të kryerës përcaktohet nga konteksti. Në rastin e parë më se e kryera përdoret si një e kryer e së shkuarës, kurse në rastin e dytë ka vlerën e një të kryerës të thjeshtë të së shkuarës. Kjo duket qartë në dy periudhat e mëposhtme me ligjëratat të zhdrejta. Në rast se do të ishte përdorur ligjëratat e drejtë, atëherë foljet do të ishin vënë një herë në të kryerën dhe një herë në të kryerën e thjeshtë, në varësi nga kuptimi kohor i tyre.

Po ta kthejmë përmbajtjen e raportit të komandantit të kampit në ligjëratat të drejtë, atëherë të gjitha foljet e nënvizuara do të vihen në kohën e kryer:



Po ta kthejmë këtë periudhë në ligjëratë të drejtë, atëherë folja e nënvizuar do të vihet në të kryerën e thjeshtë.

Në të dyat këto përdorime më se e kryera mund të shoqërohet me tregues kohorë, që shprehen me anë të një rrethanori kohe: *që atë ditë, në atë kohë, atë vit, atë verë, gjer atëherë* etj., ose me anë të një fjalie të varur kohore (të ndërtuar zakonisht me anë të lidhëzës nënrënditëse *para se*). Por treguesi kohor mund të nënkuptohet nga sa është thënë më parë e atëherë mund të mos shprehet.

Më se e kryera përdoret aty-ktu, sidomos në gjuhën e folur, edhe me vlerën e së kryerës së mënyrës kushtore nëpër apodosa periudhash hipotetike.

Më se e kryera e dytë haste më fort nëpër të folmet e Shqipërisë Veriore, kurse në shqipen letrare ndeshet tepër rrallë. Ajo përdoret për të treguar përfundimin e një veprimi para një çasti shumë të largët të së shkuarës.

*Merr pelhuren, qi pat enë
Bija e sajë; kishte pasë kenë
Kuç e zi e m' te qindisë
Gjet dashtnin qi e kisht' molisë.
N' krye t' flamurit kisht' punue,
Per rreth shqypje, m' dorë prarue,
Fjalët e hershme, fjalët e të Parve:
Se Shqypnia asht e Shqyptarve;
E nder skaje fjalët "liri".
Merr nanë-shkreta e pshtuell at bi,
Qi, pa njoftët tjetër dashtni,
Ishte shkri vec per Shqypni. -(Mjeda, N., Grueja shqyptare (Amë e bi))
E kush kalote at ditë bri meje,
At ditë qi dhima m' kish xjerrë mendt kreje,
Thote perajshem: Paska metë shkret!
Zot, njitja doren, majen ti ngiet! -(Mjeda, N., Djali pa nanë si nata pa hanë)
Lodhë prej vegësh, prej rrangësh shpijet,
si u ba natë, ndej Zoga n'votër;
ndej m'u xe me dru dullijet
që kish ba n'për mal, pa motër! (Mjeda, N., 1999, Juvenilja dhe vjersha të tjera, fq. 42)*

*(Ngrimun n'ar, mbi 'i pullali
nën balkue nji beg kish dalë;
holl' e i gjatë porsì selvi
n'rrugë nën gardh ish dukë nji djalë.)! (Mjeda, N., 1999, Juvenilja dhe vjersha të tjera,
Tiranë, fq. 42)*

...



SISTEMI FOLJOR I NDRE MJEDËS

Fitore Imeri,

Prej nën një tjegllat **kish dalë** si 'j tra,
ku një mij' tasha vëlloshin pa da;
përmbi shpi ndihej tue rrahun troka
e ushtonte toka ! (Mjeda, N., 1999, Juvenilja dhe vjersha të tjera, Tiranë, fq. 42)

Rreze flak' arit. Por rrotull fëtyra
e fushës kish nd'rrue; **kish nd'rruemun** zyra
e bimës e e pem've; përmbi balkue
deri **kish nd'rrue**. (Mjeda, N., 1999, Juvenilja dhe vjersha të tjera, Tiranë, fq. 42)

...
Nuk e **kish vrumun** kurr nder dit' t'veta
at rrugë n'balkue. Ktheheshin me çeta
asaj katundsit, tue dalë pa pra
e ajo s'**kish pa**. (Mjeda, N., 1999, Juvenilja dhe vjersha të tjera, Tiranë, fq. 42)

E disprohet me vetveti
që nuk bani kurrnji djalë:
sot e reja i **kish dalë**
bashkë me dritë për dru në shpat. (Mjeda, N., 1999, Juvenilja dhe vjersha të tjera,
Tiranë, fq. 48)

Kish mbajtë zjermin ndezë mbi votër,
ia **kish njomë** njat buk' e mjera;
edhe Lokja me gjith' tjera
kishte dalë me petka n'shtat. (Mjeda, N., 1999, Juvenilja dhe vjersha të tjera, Tiranë,
fq. 48)

Kish shkue motin si pranvera
me ndo'j fëmijë tu' e kalamendun;
ishte knaqë tue u përmendun
tash e tash ferishta n'djep. (Mjeda, N., 1999, Juvenilja dhe vjersha të tjera, Tiranë, fq.
48)

"T'kishe dekë ma mirë, o i mjerë -
thotë sa herë, -
Afër nanës që t'desh e t'ruejti;
t'kishe mbyllë me duer te mia
këtu te shpia
njata sy që mordja shuejti (Mjeda, N., 1999, Juvenilja dhe vjersha të tjera, Tiranë, fq.
48) dhe (Mjeda, N., 2002, Vepra letrare, I tretuni, fq. 15)



*Afër vorrit tand nan-shkreta
porsi bleta
ishte sjellun tue gjimue
e n'at bar qe **kishte qitë**
për gjithë ditë
ndonji lule **kish kerkue...**" (Mjeda, N., 1999, *Juvenilja dhe vjersha të tjera*, Tiranë, fq. 48) dhe (Mjeda, N., 2002, *Vepra letrare, I tretuni*, fq. 15)*

*E kush kalote at ditë bri meje,
At ditë qi dhima m' **kish xjerrë** mendt kreje,
Thote perajshem: Paska metë shkret!
Zot, njitja doren, majen ti ngiet! (Mjeda, N., 2002, *Vepra letrare, Djali pa nenë si nata pa henë Bukuri e virtyt*, fq. 96)*

E kryera e tejshkuar. -Kuptimi themelor i së kryerës së tejshkuar është të tregojë një veprim të përfunduar para një çasti të caktuar të së shkuarës. Në këtë kuptim, siç shihet, ajo është sinonime me më se të kryerës.

Nga këto dy forma gramatikore sinonime në gjuhën e sotme letrare përdoret shumë më dendur më se e kryera, kurse e kryera e tejshkuar haste rrallë. Kjo dukuri do lidhur edhe me dukurinë e zëvendësimit të së kryerës së thjeshtë të foljeve *jam* e *kam* nga forma e së pakryerës. Por aty-këtu haste edhe dukuria e kundërt.

Në fjalitë e varura kohore, të ndërtuara me anë të lidhëzës nënrenditëse si (a pasi), në vend të së kryerës së tejshkuar përdoret jo rrallë e kryera e thjeshtë:

Kjo formë përdoret më fort për të shprehur veprime të mundshme të së shkuarës. Në këtë përdorim ajo është e barasvlershme me të kryerën e mundshme lidhore, të prirë nga folja me vlerë modale *mund*:

*Porsa ditës i **pat xanë** filli,
Drandofillja muer me cilë
Gjetht e vet e andej prej qielli
Pritte voesen per shtat t' vet.
Kqyra n' nesret, gjetht kish' mshilë,
Dikush ksajë shpejt tash i a shklet. (Mjeda, N., *Bukuri e virtyt*)*

*Ah! se fort m' dote, se fort m' **pat gzue**,
Sa gjallë, e mjera, rrite me mue!
Por qe, se une nanen sot ma s' e kam;
Un nafakpremi, c' se i vorfen jam! (Mjeda, N., 2002, *Vepra letrare, Djali pa nenë si nata pa henë*, fq. 96)*



*Arit i kishte floket, e kish si zgjeta
Driten e syve e mollzat rrumbullake,
E buzet e vocrra me te ngjyeme gjake,
Qe kur i pash krejt i mahnitun mbeta. (Mjeda, N., 1999, Juvenilja dhe vjersha të tjera,
Tiranë, fq. 42) dhe (Mjeda, N., 2002, Vepra letrare, Andra, fq. 35)*

*E, i dish'ruem, bje për fushore
me rritë bimën për gjith' vend,
ku 'j erë akullit mizore
kishte hupë lul'zim e shend. (Mjeda, N., 1999, Juvenilja dhe vjersha të tjera, Tiranë, fq.
42)*

*Kish mbajtë zjermin ndezë mbi votër,
ia kish njomë njat buk' e mjera;
edhe Lokja me gjith' tjera
kishte dalë me petka n'shtat. (Mjeda, N., 1999, Juvenilja dhe vjersha të tjera, Tiranë,
fq. 48)*

*Afër vorrit tand nan-shkreta
porsi bleta
ishte sjellun tue gjimue
e n'at bar qe **kishte qitë**
për gjithë ditë
ndonji lule **kish kerkue...**" (Mjeda, N., 1999, Juvenilja dhe vjersha të tjera, Tiranë, fq.
24)*

KOHA E ARDHME

Kjo kohë del e përdorur kryesisht në formën analitike konservatore me karakter dialektor, të nëntipitë së ardhmes me “kam” + lidhore. Gjithashtu gjejmë përdorim të tipit do+ lidhore, por në mjaft raste koha e ardhme shprehet me forma të tjera si: me anë të mënyrës lidhore, apo me ndihmën e kohës së tashme të mënyrës dëftore. Këto të dhëna flasin për zhvillimet e brendshme të shqipes, e cila për të shprehur kuptimin kohor të së ardhmes ka krijuar forma analitike nga togje foljore, ku si folje ndihmëse ose modale shërbejnë foljet *dua* dhe *kam*, ndërsa folja kryesore mund të jetë në mënyrën lidhore ose në formën e paskajores.

Trajtat e kohës së ardhme paraqiten në tri forma:



SISTEMI FOLJOR I NDRE MJEDËS

Fitore Imeri,

Me foljen “kam” (e cila e ruan trajtën e saj të pangurosur d.m.th. ndryshon sipas vetave dhe numrit) + lidhoren me ruajtje të pjesëzës të: p.sh. *jetër sa kam të rronj*, pra cë zot *kee të na ljësh*; pse na *kem t'ikim*?

Trajta me mungesë të foljes dhe ruajtjen e pjesëzën- të, të lidhores: Trajtat e së ardhmes së dëftores në raste të veçanta dalin edhe në forma të shkurtuara, si me mungesën e foljes *kam*, e cila formalisht del si në të tashmen e lidhores, por mund të zëvendësohet fare natyrshëm me kohën e ardhme të dëftores. Formalisht format foljore shfaqen të ngjashme me të tashmen lidhore joveprore, por kuptimisht zëvendësohen natyrshëm me të ardhmen. Duhet thënë se si strukturë gjendet dhe në shqipen e sotme. (Nga të nisët këtë herë). Këtë lëvizje kuptimore foljes ia lejon modaliteti i lidhores. Fanëmir ajo kopile cë te krahu *ti pushoonj!* Në këtë rast folja del formalisht si e tashme, por kuptimisht si e ardhme e thjeshtë. Në mbaresë ruhet (të paktën në të shkruar) *n*-ja që sot ka rënë në shumicën e të folmeve tona dhe vihet re mungesa e ë-së fundore.

Trajta pa pjesëzën –të, të lidhores: që na vien nesërith / *kanë daljen* (do të dalin) ndër dherat anë. Përdorime të tilla, ku folja shfaqet në të tashmen e dëftores, po me kuptimin e së ardhmes, janë të zakonshme në shqipen e sotme.

Një nga dukuritë që i dallon të folmet e shqipes është edhe formimi i trajtave të së ardhmes me ndihmësen kam: tipi kam me ba përdoret vetëm në të folmet gege, sidomos në gegërishten veriore, tipi kam për të bërë del më dendur në të folmet jugore dhe në atë të Shqipërisë së Mesme.

E ardhmja e tipit “kam” + lidhore në të folmet gege është e vjetër.

Trajta e së ardhmes me “kam” + lidhore ndeshet dendur në të gjitha të folmet ku, sipas vëzhgimeve dhe materialeve tona, ajo del në dy forma: a) folja “kam” (e cila e ruan trajtën e saj të pangurosur d.m.th. ndryshon sipas vetave dhe numrit) + lidhoren me pjesëzën të: p.sh. kam të thom, ke të thuash, ka të thotë, kemi të thomi, keni të thoni, kan(ë) të thonjën; b) me foljen “kam” + lidhoren pa pjesëzën të: p.sh. kam thom, kam bënj, kem i thomi etj.

E ardhmja e së shkuarës. -Kuptimi themelor i së ardhmes së të shkuarës është të tregojë një veprim, që pritej të kryhej pas një çasti të caktuar të së shkuarës. Me këtë kuptim ajo përdoret në ligjëratë të zhdrejtë në vend të kohës së ardhme të ligjëratës së drejtë.

Por, kur veprimi i emëruar nga folja në kohën e ardhme të ligjeratës së drejtë është një veprim që pritet të kryet pas çastit të kthimit të saj në ligjeratë të zhdrejtë, atëherë koha e foljes mbetet e pandryshuar:

E ardhmja e së shkuarës përdoret edhe nëpër fjali të varura, kryesisht kundrinore, kur në fjalinë drejtuese kallëzuesi është një folje që tregon të menduar e të pandehur: *mendoj, kujtoj, pandeh, shpresoj* etj., në të kryerën e thjeshtë ose në të pakryerën

Po në ato rrethana, në të cilat e ardhmja zëvendësohet nga e ardhmja e së shkuarës, edhe forma e tipit do të kam larë zëvendësohet nga forma e tipit **do të kisha larë**, e cila në këtë rast



SISTEMI FOLJOR I NDRE MJEDËS

Fitore Imeri,

shërben për të shprehur një veprim, që mund të jetë kryer para një çasti të caktuar të së shkuarës. Por do pasur parasysh se kjo formë foljore me kuptim përdoret më rrallë.

Forma në shqyrtim ndeshet disi më shumë si një e shkuar e formës së tipit *do të kem larë* të përdorur për të shprehur një veprim të mundshëm të së shkuarës.

Mend e zemër për të shkrijë

e përtriji

nam e lavd kur t'i vijë dita"

Mbas fjalësh t'tua përherë shkova

e t'ndigjova:

shqiptarin' nuk e korrita (Mjeda, N., 1999, Juvenilja dhe vjersha të tjera, Tiranë, fq. 24)

- Po cka kje qi lodt t' i xori?

Ku kje dhima, a ku kje zori?

A por, drue, mos m'je harlisë,

Qysh se kjan - o tuj qindisë.

Pasha nanen nuk mund t' bari,

Qi të me ndezet bija zhari!

***Do t' a dije** e zeza nanë,*

Pse ti vetllat shpesh m' i vranë;

Pse c' kah mot, moj, buza s' t' qeshet

E n' argtime zemra s' t' ndeshet. - (Mjeda, N., Grueja shqyptare (Amë e bi))

*Se c' **do t' ket** mali, qi gjimon?*

*C' **do t' jet** kjo valle, qi jehon?*

Rrethue me lule t' blera,

Me 'i zemer si prendvera,

Atdheut Shqyptari,

Si i a la i Pari,

I kndon sot valle:

Shqypnin madhnon,

Kah valle kndon. (Mjeda, N., Shqypni e s' ke! Shqyptari e Bylbyli)

Kndo pra, Shqyptar, si zemra t' do,

Vijo nder valle e mos pusho:

Diftoj ti botës krenare,

Se s' ka me zemer shqyptare;

Se ka Shqypni

*Se lir **do t' rrojë,***

Se, pose Shqyptarësh,



Kush s' do t' a gzojë.

Vetë Perendija

Tha, se Shqypnija

Asht per Shqyptarë:

Shqypitari e gzoftë. (Mjeda, N., Shqypni e s' ke! Shqypitari e Bylbyli)

Ah! po, se dhima zemret nuk m' shkepët,

C' se gjithkund nanen me e lypun m' nepët;

Do t' m' mysë mjerimi, s'kam si gjallnoj,

Pse deka e nanës zemren m' a imtoj. (Mjeda, N., 2002, Vepra letrare, Djali pa nenë si nata pa henë, fq. 96)

Por, ndale vajin, jeto pa drojë,

Mendo se drita prap do t' agojë,

Kur nder Qiell t' epra Zoti tash t' thrrët:

Rrethue me lule, nana aty t' pret. (Mjeda, N., 2002, Vepra letrare, Djali pa nenë si nata pa henë, fq. 96)

MËNYRA HABITORE

Kuptimi i mënyrës habitore. Me anë të mënyrës habitore shprehet në përgjithësi modaliteti i vërtetësisë, i shoqëruar edhe me ndjenjën e habitës së folësit për një veprim të papritur, që është kryer në të shkuarën ose që kryet në çastin e ligjëritimit. Anasjelltas, kur folësi shpreh habinë për moskryerjen e një veprimi në të shkuarën ose në çastin e ligjëritimit, atëherë i shoqëron format e mënyrës habitore me pjesëzën e mohimit *nuk* ose *s'*.

Nëpërmjet mënyrës habitore folësi mund të shpreh edhe dyshimin ose mospajtimin e tij e ndonjëherë edhe ironi lidhur me një veprim, thënjie a pohim të një tjetri. Si rrjedhim, format kohore të mënyrës habitore përdoren edhe për të përsëritur me nota mospajtimi, kundërshtimi, ironie, përbuzjeje etj., fjalët e ndonjë tjetri. Në raste të tilla ajo mund të shoqërohet edhe me pjesëzën e dyshimit *gjoja*,

Mënyra habitore ka dy kohë kryesore: të tashmen dhe të shkuarën. Kjo e fundit ka tri nënndarje: *të pakryerën, të kryerën dhe më se të kryerën*. Rrallëherë përdoret edhe një formë e kohës së ardhme e tipit do të lakam. Gjithashtu ndeshen edhe forma të mbipërbëra të së kryerës.

Nga format kohore të habitores më dendur përdoren e tashmja dhe e kryera, që lidhen drejtpërdrejt me çastin e ligjëritimit. Më pak ndeshen e pakryera dhe me se kryera. Format kohore të habitores përdoren si ne fjali të pavarura dhe kryesore, ashtu edhe ne fjali të



nënrenditura. E tashmja dhe e kryera përdoren më fort fjali të pavarura dhe kryesore, kurse më se e kryera ndeshet më shume në fjali të nënrenditura. Edhe e pakryera ndeshet disi më shumë në fjali të nënrenditura.

Mënyra habitore përdoret zakonisht për të shprehur habinë, dyshimin, mospajtimin etj. Të folësit për një veprim të caktuar. Por veprimi që ngjall habinë, dyshimin etj. Të folësit, mund të jetë edhe i tillë që përsëritet herë pas here, ose që mund të ketë vlerë mbarëkohore.

*Pajto, sa a' tuj t'pritun,
Pajto, e ato faje
Pendesa t' i laje;
N' pajtim mos vano! (Mjeda, N., Fuqija e uratës)*

*A keni ndie ndikund, kah fluturoni
ndër shkrepa, me ushtue kangën e saj?
A keni ndie një kangë të patravajë?
O shqipe, o zogjt' e maleve, kallzoni! (Mjeda, N., 1999, Juvenilja dhe vjersha të tjera,
Tiranë, fq. 117)*

*Vlon dashtni, si n'bija nanash!
Nane, dashtnija m' ka molisë,
Prandej kja - o tuj qindisë! - (Mjeda, N., Grueja shqyptare (Amë e bi))*

Koha e tashme.-Kuptimi themelor i foljes në kohën e tashme të mënyrës habitore është të shprehë habinë, dyshimin, mospajtimin etj., të folësit për një veprim të caktuar që vazhdon të kryhet deri në çastin e ligjërimit. Në këtë përdorim e tashmja e habitores mund të shoqërohet me pjesëzën po.

E tashmja e habitores përdoret edhe për të shprehur habinë, dyshimin, mospajtimin etj., të folësit për një veprim që përsëritet herë pas here, ose që ka vlerë mbarëkohore. Në këtë rast ajo, ashtu si e tashmja e dëftorës me kuptim mbarëkohore, nuk shoqërohet me pjesëzën po.

E tashmja e mënyrës habitore përdoret më fort në fjali të pavarura dhe kryesore. Por ajo ndeshet edhe nëpër fjali të nënrenditura.

*- Nanë, dashtnija m' ka molisë;
Kjava mjaft-o tuj qindisë!
Kjava mjaft... - Ma desht t'ligjrojë,
Por i u kput ksajë fjala n' gojë.
Si fjalë tjera nuk mund të xori,
Mndash, gjylpanë prap n' dorë i mori;
Por dy duerët, porsi florini,*



Mi pelhurë deka i a ngrini. (Mjeda, N., Grueja shqyptare (Amë e bi))

*E kush kalote at ditë bri meje,
At ditë qi dhima m' kish xjerrë mendt kreje,
Thote perajshem: **Paska metë shkret!***

Zot, njitja doren, majen ti ngiet! (Mjeda, N., 2002, Vepra letrare, Djali pa nenë si nata pa henë, fq. 96)

Koha e shkuar

E pakryera.- E pakryera e habitores përdoret zakonisht për të shprehur habinë, dyshimin, mospajtimin etj, të folësit për një veprim të caktuar, që vazhdonte ende në një çast të caktuar të së shkuarës. Në këtë rast ajo mund të shoqërohet (rrallëherë) me pjesëzën *po*. Por, ashtu si koha e tashme, e pakryera e habitores përdoret edhe për të shprehur habinë, dyshimin, mospajtimin etj., të folësit për një veprim që është përsëritur herë pas here në të shkuarën, ose që ka vlerë mbarëkohore. Në këtë përdorim ajo nuk shoqërohet me pjesëzën *po*. E pakryera e habitores përdoret disi më dendur në fjali të nënrenditura. Por ajo ndeshet edhe nëpër fjali të pavarura dhe kryesore.

Ne veprat e analizuara të ndre mjedës, vërhet se nuk ka ka ndonjë flaji të formës Habitore në kohën e pakryer.

E kryera.- E kryera e habitores përdoret për të shprehur habinë, dyshimin, mospajtimin etj., të folësit për një veprim të përfunduar, që nuk i ka këputur lidhjet me çastin e ligjërimit. Kjo kohë e habitores përdoret më fort në fjali të pavarura dhe kryesore, por ajo ndeshet edhe në fjali të nënrenditura.

*E kush kalote at ditë bri meje,
At ditë qi dhima m' kish xjerrë mendt kreje,
Thote perajshem: **Paska metë shkret!***

Zot, njitja doren, majen ti ngiet! (Mjeda, N., 2002, Vepra letrare, Djali pa nenë si nata pa henë, fq. 96)

Më se e kryera.- Më së e kryera e habitores përdoret për të shprehur habinë, dyshimin, mospajtimin etj., të folësit për një veprim që është përfunduar para një çasti të caktuar të së shkuarës. Kjo formë kohore përdoret më fort në fjali të nënrenditura, por ajo ndeshet edhe në fjali të pavarura dhe kryesore.



MËNYRA LIDHORE

Mënyra lidhore në gjuhën shqipe është parë si një nga dy mënyrat që shprehin modalitetin e mundësisë (lidhorma bashkë me kushtoren janë grupuar në të njëjtin grup). Një fakt i tillë ka kushtëzuar dhe numrin e paradigmeve me të cilat e gjejmë në shqipen e sotme. Edhe në materialin e analizuar numri i formave foljore të përdorura është i madh.

Në shqipen e sotme gjenden katër kohë përkatësisht në veprorë dhe joveprorë. Formanti dallues i saj të dhe një pjesë ndajshitesash të ndryshme nga dëftorja, krijojnë dhe kundërvëniet formale që e identifikojnë këtë mënyrë nga të tjerat.

Sikurse vihet re folja *vij* në mënyrën lidhore tek Mjeda shfaqet me një temë tërësisht të ndryshme nga ajo e sotmja. Pavarësisht nga kjo, tema e foljes mbaron me zanore dhe merr mbaresa në tri vetat e para, kështu që sipas klasifikimit të sotëm ajo mund të shihet në grupin e foljeve të zgjedhimit të parë.

Nga ana tjetër, mbaresat që merr në të tashmen e dëftores ndryshojnë në një pjesë të tyre nga ato të sotmet. E kemi fjalën për vetën e parë dhe të tretë njëjës e cila del me –n.

Veta e dytë njëjës dhe shumës, shfaqet e njëjtë me formën e sotme. Duhet sqaruar se pavarësisht se në pamje të parë mbaresa është e njëjtë, në fakt këto dy veta dallohen nga ndryshimet në teme, pasi në vetën e tretë njëjës shfaqet një zanore e –o- e dyfishuar, që sipas nesh përfaqëson një zanore të gjatë.

Mbaresat e shumës të vetës së parë dhe të tretë gjithashtu dalin në variantin –mi dhe –nën, të cilat sipas nesh nuk janë shumë larg varianteve të sotme dhe mund të shpjegohen ndryshimet fonetike që vihen re me anë të rregullave të Fonetikës historike.

Kuptimi i mënyrës lidhore.– Me anë të mënyrës lidhore, shprehet kryesisht modaliteti i mundësisë. Por në disa përdorime ajo shpreh edhe modalitetin e dëshirës ose të detyrimit. Pra, me anë të kësaj mënyre folësi e paraqit si të mundshme, përkatësisht të dëshirueshme ose të detyrueshme kryerjen e veprimit të emëruar nga folja.

Ja edhe disa shembuj të krahasuar me folje në mënyra dëftore e lidhore, për ta bërë edhe më të qartë modalitetin e shprehur nga folja në mënyrën lidhore.

Mënyra lidhore ka dy kohë: të tashmen dhe të shkuarën. Kjo e fundit ka tri nënndarje: të pakryerën, të kryerën dhe mëse të kryerën.

*T'lypë një bes' e ta nep t'ndershme
dora e unazaqë t'ven n'gisht;
e ndërmyjet pr'at besë t'gjithhershme
a dorzan' i lumi Krisht. (Mjeda, N., 1999, Juvenilja dhe vjersha të tjera, Tiranë, fq. 42)*

*Sogjetarë, porsì furia
e një rrfes' që qetat shpon,
janë të qiellit nalt ushtria*



e n'dorë shpata iu veton. (Mjeda, N., 1999, Juvenilja dhe vjersha të tjera, Tiranë, fq. 42)

*Por s'i giet qielli,
nuk i giet prilli
as fllad që shetitë lulet
e me erna veshet,
foshnjës që i qeshet*

nanës, kur mbi 'të përkulet. (Mjeda, N., 1999, Juvenilja dhe vjersha të tjera, Tiranë, fq. 44)

*Mend e zemër për të shkriji
e përtriji
nam e lavd kur t'i vijë dita"
Mbas fjalësh t'tua përherë shkova
e t'ndigjova:*

shqiptarin' nuk e korrita (Mjeda, N., 1999, Juvenilja dhe vjersha të tjera, Tiranë, fq. 24)

*- Po cka kje qi lodt t' i xori?
Ku kje dhima, a ku kje zori?
A por, drue, mos m'je harlisë,
Qysh se kjan - o tuj qindisë.
Pasha nanen nuk mund t' bari,
Qi të me ndezet bija zhari!
Do t' a dije e zeza nanë,
Pse ti vetllat shpesh m' i vranë;
Pse c' kah mot, moj, buza s' t' qeshet
E n' argtime zemra s' t' ndeshet. - (Mjeda, N., Grueja shqyptare (Amë e bi))*

*Ty due fjalët me t' i ndigiue,
As s' kam mend me t' u largue.
Zemren dysh un s' mund e daj:
M' len t' qindisi, m' len të kjaj! - (Mjeda, N., Grueja shqyptare (Amë e bi))*

*Nanë, dashtnija m' ka molisë;
Kjava mjaft-o tuj qindisë!
Kjava mjaft... - Ma desht t'ligjrojë,
Por i u kput ksajë fjala n' gojë.*



Si fjalë tjera nuk mund të xori,

Mndash, gjylpanë prap n' dorë i mori;

Por dy duerët, porsi florini,

Mi pelhurë deka i a ngrini. (Mjeda, N., Grueja shqyptare (Amë e bi))

Në mënyrën lidhore, në kohën e tashme foljet kam dhe jam shfaqin si veçori përdorimin e zanoreve të gjata. Në numrin shumë folja kam, në vetën e dytë shfaq një temë më të zgjeruar se e zakonshmja në të cilën jo vetëm nuk ka ndodhur shndërrimi i –i –së në –e, sikurse të folja jam, veta e dytë shumë, por shfaqet edhe një element i ndërmjetëm –jë. Në kohën e pakryer shfaqen për disa veta edhe variante dytësore, të cilat janë më arkaike se të parat dhe janë njësoj me çamërishten. Folja jam në kohën e tashme në vetat e njëjësit shfaq dyfishim zanore, ndërkohë në vetën e tretë njëjës vihet re mungesa e ë-së fundore, e cila justifikohet nga ekzistenca e zanores së gjatë brenda temës. Folja kam në kohën e pakryer shfaqet në dy variante ku varianti i parë është afër shqipes së sotme. Në variantin e dytë, i cili është më konservator dhe njësoj si në çamërisht, veta e tretë njëjës nuk del mbaresat e sotme.

Koha e tashme.- Kuptimi themelor i foljes në kohën e tashme të mënyrës lidhore është të tregojë një veprim, kryerjen e të cilit folësi e paraqit si të mundshme a të dëshirueshme.

E tashmja e mënyrës lidhore përdoret si në fjali të varur ashtu edhe në fjali të pavarura ose kryesore. Në fjalitë e varura ajo shpreh kryesisht modalitetin e mundësisë, i cili mund të përfordhet duke vendosur para saj foljen me vlerë modale *mund*. Por, kur prihet nga folja me vlerë modale *duhet* (a *lipset*), ose nga ndonjë togfjalësh që shpreh modalitet detyrim (*si është e nevojshme* etj.), atëherë kjo i jep mundësi të tashmes së lidhore të shprehë një veprim, që folësi e quan të detyrueshëm, të domosdoshëm.

Në fjalitë e varura e lidhore mund të përdoret pa ndonjë lidhëz nënrenditëse, ose mund të prihet nga lidhëzat nënrenditëse filluese: *që, qëllimore: që, me qëllim që*; kohore: *si, pasi, kur, sa, porsa, para se, sa herë që*; vendore: *kudo që, ngado që, ku, nga*; kushtore: *po, sikur*; lejore: *sado që, sido, sido që, edhe pse, edhe sikur* etj., nga lidhëzat nënrenditëse kundërvënëse në vend që, si edhe nga përemrat lidhorë: *që, i cili, kush, ç', cili, sa*.

Pas lidhëzave nënrenditëse filluese (që), kohore (me përjashtim të para se), vendore dhe lejore (sado që, sido që), si edhe pas përemrave lidhorë përdoret e tashmja e dëftorës, kur veprimin e emëruar nga folja folësi e paraqit si një veprim të caktuar, që kryet në kohën e tashme, ose si një veprim të pacaktuar, dhe jo si një veprim të mundshëm të së ardhmes.

Në fjalitë e varura kundrinore (të prira ose jo nga lidhëza nënrenditëse filluese që) përdoret detyrimisht e tashmja e lidhore, në rast se folja e fjalisë drejtuese, në kohën e tashme, në të ardhmen ose në të kryerën shpreh vullnet a dëshirë (si: dua, dëshiroj, uroj, urdhëroj, porositi, kërkoi, them, këshilloj, lut etj.), ose qëndrimin e një njeriu (si: mendoj, preferoj, duroj, lë, lejoj, ndaloj, kundërshtoj, dyshoj, nuk besoj, pres, parashikoj etj.).

Në gjuhën e folur dhe në të shkruarën, të tashmen e lidhore e gjejmë të përdorur edhe në vend të së pakryerës. Kjo ndodh kur ajo përdoret pas foljesh në të pakryerën, në të kryerën e



SISTEMI FOLJOR I NDRE MJEDËS

Fitore Imeri,

thjeshtë ose në mëse të kryerën a të kryerën e tejshkuar, d. m. th. pas formash kohore, që nuk lidhen me çastin e ligjërimin.

Megjithatë, ka raste që edhe pas së kryerës së thjeshtë duhet përdorur e tashmja e lidhore. Kjo ndodh atëherë kur kthejmë në ligjeratë të zhdrejtë një ligjëratë të drejtë, që përmban një urdhër, i cili pritet të zbatohet pas çastit, kur bëhet ky ndryshim ligjerate, ose kur e kryera e thjeshtë është përdorur me kuptimin e së kryerës;

E tashmja e lidhore përdoret edhe pas së kryerës së thjeshtë, kur kjo përdoret me kuptimin e së ardhmes: *Po erdhi njeri të më kërktojë, thuajti. . .*

E tashmja e lidhore përdoret edhe në fjali të pavarura ose kryesore. Në fjali të tilla ajo shpreh modalitetin e mundësisë, të detyrimit ose të dëshirës. Në këtë përdorim ajo shpreh më fort kuptimin kohor të së ardhmes.

Modalitetin e mundësisë ose të detyrimit ajo e shpreh:

Kur përdoret në fjali pytëse të drejta që nisin me një fjalë pytëse (përemër pytës, ndajfolje pytëse ose pjesëzës pytëse), ose pa ndonjë fjalë të tillë.

Kur përdoret në fjali pytëse – thirrmore, përkatësisht thirrmore, nëpërmjet të cilave folësi shpreh një ndjenjë zemërimi, proteste, habie, dëshire etj.

Kurse modalitetin e dëshirës e tashmja e lidhore e shpreh atëherë kur përdoret:

Me vlerën e mënyrës urdhërore (për urdhra, nxitje, këshilla, propozime etj.). Ajo përdoret kështu jo vetëm në vetën e parë (shumës) dhe në vetën e tretë (njëjës e shumës), për të cilat urdhëroja nuk ka forma gramatikore të posaçme, por edhe në vetën e dytë.

*Ty due fjalët me t' i ndigiue,
As s' kam mend me t' u largue.
Zemren dysh un s' mund e daj:
M' len t' qindisi, m' len të kjaj! - (Mjeda, N., Grueja shqyptare (Amë e bi))*

*Nanë, dashtnija m' ka molisë;
Kjava mjaft-o tuj qindisë!
Kjava mjaft... - Ma desht t'ligjrojë,
Por i u kput ksajë fjala n' gojë.
Si fjalë tjera nuk mund të xori,
Mndash, gjylpanë prap n' dorë i mori;
Por dy duerët, porsi florini,
Mi pelhurë deka i a ngrini. (Mjeda, N., Grueja shqyptare (Amë e bi))*



Koha e shkuar

E pakryera.- Kuptimi themelor i së pakryerës së lidhore është të tregojë një veprim të mundshëm të së shkuarës. Kjo është më fortë një e tashme e lidhore në të shkuarën dhe përdorimi i saj në fjalitë e varura është i kushtëzuar vetëm nga koha e foljes drejtuese. Ajo përdoret në shumicën e atyre rasteve, në të cilat përdoret edhe e tashmja e lidhore, por vetëm pas formash kohore, që nuk lidhen me çastin e ligjëritimit, d. m. th. pas së kryerjes së thjeshtë, së pakryerës, më se të kryerës së tejshkuar.

Në fjali të pavarur ose kryesore e pakryera e lidhore përdoret me modalitetin e mundësisë, përkatësisht të detyrimit.

Kur prihet nga foljet me vlerë modale *mund* (në formë të ngurosur ose në një nga format e së shkuarës, përveç së kryerës) dhe *duhet* (në një nga format e së shkuarës, përveç së kryerës). Përdorimi i saj, pas formës *duhet* të kohës së tashme është mirë të mënjanohet nga gjuha letrare:

Kur përdoret në fjali pytëse të drejta, në raste se veprimi, për të cilin petet, i referohet një çasti të caktuar të së shkuarës:

Kur përdoret në fjali pytëse-thirrmore, përkatësisht thirrmore, nëpërmjet të cilave folësi shpreh një ndjenjë zemërimi, proteste, habie, dëshire etj. Lidhur me një veprim të caktuar të së shkuarës:

Kur folësi kërkon t'i tregojë bashkëbiseduesit se si duhej të ishte vepruar në një situatë të dhënë të së shkuarës. Në këtë rast e pakryera e lidhore mund të shoqërohet edhe me foljen modale *duhet*.

Në fjalitë e varura kushtore të ndërtuara me lidhëzat nënrenditëse po, sikur, ose pa ndonjë lidhëz, kuptimi kohor i së pakryerës është i papërcaktuar. Në këto ndërtime ajo përdoret më fort me kuptimin e kohës së tashmes të lidhore për të shprehur një kusht të së ardhmes, që, sipas folësit nuk ka ose ka pak mundësi për t'u realizuar:

Në vend të formave të drejta të së kryerës së foljes jam (të isha, të ishe etj.) në gjuhën e folur e aty-këtu edhe në shqipen e shkruar hasen format joletrare të qeshë, të që etj., të cilat duhen mënjanoar: Dhanë e morën, e kthyen mbarë e prapë atë të flamosur gjuhë, sikur të që (të ishte) pe e s'futej dor në vrimën e gjilpërës.

Nanë, dashtnija m' ka molisë;

Kjava mjaft-o tuj qindisë!

Kjava mjaft... - Ma desht t'ligjrojë,

Por i u kput ksajë fjala n' gojë.

Si fjalë tjera nuk mund të xori,

Mndash, gjylpanë prap n' dorë i mori;

Por dy duerët, porsi florini,

Mi pelhurë deka i a ngrini. (Mjeda, N., Grueja shqyptare (Amë e bi))



E kryera.- Kuptimi themelor i së kryerës së lidhores është të tregojë një veprim, që mund të jetë kryer para çastit të ligjërit, me të cilit nuk i ka të këputura lidhjet. E përdorur me këtë kuptim, e kryera e lidhores mund të prihet nga folja me vlerë modale *mund* në formën e saj të ngurosur. Por, kur prihet nga folja me vlerë modale *duhet* në formën e kohës së tashme, atëherë kjo i jep mundësi foljes në të kryerën e lidhores të shprehë modalitetin e detyrimit, ndonjëherë edhe të mundësisë. Ashtu si e tashmja dhe e pakryera, edhe e kryera e lidhores, e shoqëruar nga foljet gjysmëndihmëse *mund* dhe *duhet*, përdoret rëndom si në fjali të pavarura ose kryesore, si në fjali të varura.

E pashoqëruar nga ndonjë prej foljeve modale, që u përmendën më sipër, e kryera e lidhores përdoret kryesisht në fjali të varura kryefjalore e kundrinore, sidomos pas foljesh, që shprehin vullnetin ose qëndrimin e folësit në kohën e tashme të dëftorës; në fjali të varura kohore (*të ndërtuar me lidhëzat kur, si, pasi* etj.), vendore (*të ndërtuara me lidhëzat kudo që, ngado që*), kushtore (*të ndërtuara me lidhëzat po, sikur*) dhe lejore (*të ndërtuara me lidhëzat, sado, sado që, sido, sido që, edhe sikur*) etj.

Nga pikëpamja e modalitetit mënyra kushtore, afrohet me mënyrën lidhore. Ajo është shpesh e barasvlershme me të pakryerën, përkatësisht me më se të kryerën e lidhores, të prirë nga folja modale mund. Të krahasohen:

*Kqyr njat vend ku n'mbramje rrishe
kur nuk kishe
fije idhnimi nëpër ftyrë
e ngurron, si t'kenke gurit
e, pshtetë murit
lot' i dalin rrkaje tuj kqyrë (Mjeda, N., 1999, Juvenilja dhe vjersha të tjera, Tiranë, fq.
15)*

*Se c' do t' ket mali, qi gjimon?
C' do t' jet kjo valle, qi jehon?
Rrethue me lule t' blera,
Me 'i zemer si prendvera,
Atdheut Shqyptari,
Si i a la i Pari,
I kndon sot valle:
Shqypnin madhnon,
Kah valle kndon. (Mjeda, N., Shqypni e s' ke! Shqyptari e Bylbyli)*

Numri i formave të kohëve të përbëra është mjaft i reduktuar. Mënyra e ndërtimit të kohës së kryer tësaj është e njëjtë me format e sotme, pra folja ndihmëse në këtë rast *kam* (



shfaqet më të njëjtin ndryshim fonetik me të cilin e gjejmë dhe sot *a-e*), dhe pjesoret përkatëse që nuk shfaqin ndryshime.

E veçanta qëndron në tipare fonetike arkaike të tilla si : dyfishimi i zanores - *e*- në variantin e një zanoreje të gjatë dhe tema e pjesores *rrëmpej* e cila nuk shfaq zanoren -*y* si sot, por zanoren-*i*-.

MËNYRA KUSHTORE

Mënyra kushtore në gjuhën shqipe shfaqet mjaft e larmishme dhe formalisht paraqitet me dy kohë(e tashmja: do të punoja dhe e kryera: do të kisha punuar), të cilat shihensi homologe me një pjesë të formave të së ardhmes së dëftores.

Praktikisht, ajo përgjithësisht shihet si një formë, që realizohet në kuadrin e fjalive kushtore. Nga shqyrtimi i strukturave ligjërimore ku dalin këto të fundit, lehtësisht mund të dallohet se jo në pak raste fjalitë kushtore realizohen pa përdorur foljet e mënyrës kushtore. Për këtë arsye, pavarësisht se në pamje të parë duket se mënyra kushtore nuk gjendet ,formalisht në tekstin e Juveniljes, ajo realizohet strukturalisht me folje të tjera dhe në struktura sintaksore karakteristike për të. Kështu kemi:

Se ti më merr ti ku më *çon*;

Mendojmë se kemi një rast tipik që e kemi dhe në shqipen e sotme, i cili konstruktet e kushtores nuk i shpreh me format korresponduese, të paktën në fjalinë e varur kushtore, po me forma në kohë të tjera. Këtu të dyja foljet janë në të tashmen e dëftores, pa ndryshime në temë e mbaresë. Kuptimisht folja e dytë mund të ekuivalentohet me të ardhmen,e cila shfaqet në formën e një të ardhmeje të përmbysur me vlerën e së ardhmes së të shkuarës.

Mënyra kushtore ka dy kohë: të tashmen dhe të kryerën

Me format e kushtores përdoret pjesëza e mohimit nuk ose s’

Koha e tashme.-Kuptimi i kësaj kohe të kushtores është të tregojë një veprim, që mund të kryet para ose pas çastit të ligjërimin, në rast se vërtetohet një kusht i caktuar. Pra me anë të kësaj kohe të kushtores, ndryshe nga ç’ndodh me kohën e mënyrës dëftore, folësi e paraqit veprimin e emëruar nga folja si të mundshëm, edhe po të vërtetohe kushti i shprehur nga fjalia kushtore.

Eni bija, zana malit,

Ju qi kjani n' dekë t' njëj djalit,

E, permysë mi ket bujare,

N' te nderoni bin shqyptare;



*E tuj puthë e mall e vajë
Njat flamur, qi dora e sajë
Diejti aq bukur me qindisë,
Pse dashtnija e kisht' molisë;
Lidhniu tok: Per herë dashtnija
Per vend t' uej t' u jet stolija;
Pe, po kje qi, si kjo bi,
Rriten vashat në Shqypni,
N' vend **do të shkojë**-o fjala e t' Parve,
Se Shqypnia asht e Shqyptarve.
Lidhniu tok, si bajshin motit
Ato bijat e Kastriotit,
E broh'ritni n' gzim e n' vajë:
Rrnofte Shqypnija e flam'ri i sajë. (Mjeda, N., Grueja shqyptare (Amë e bi))*

*Se c' **do t' ket** mali, qi gjimon?
C' **do t' jet** kjo valle, qi jehon?
Rrethue me lule t' blera,
Me 'i zemer si prendvera,
Atdheut Shqyptari,
Si i a la i Pari,
I kndon sot valle:
Shqypnin madhnon,
Kah valle kndon. (Mjeda, N., Shqypni e s' ke! Shqyptari e Bylbyli)*

*Kndo pra, Shqyptar, si zemra t' do,
Vijo nder valle e mos pusho:
Diftoj ti botës krenare,
Se s' ka me zemer shqyptare;
Se ka Shqypni
Se lir **do t' rrojë**,
Se, pose Shqyptarësh,
Kush s' do t' a gzojë.
Vetë Perendija
Tha, se Shqypnija
Asht per Shqyptarë:
Shqyptari e gzoftë. (Mjeda, N., Shqypni e s' ke! Shqyptari e Bylbyli)*

*Emnin e kandshem m'i a ndie kot prita
Njasajë qi n' kobe **do t' m' ishte** drita:*



*Kuej nuk i dhimem, askush s' m' kujton,
Sado qi zemra vec gjak m' pikon. (Mjeda, N., 2002, Vepra letrare, Djali pa nenë si nata
pa henë , fq. 96)*

*Ah! po, se dhima zemret nuk m' shkepet,
C' se gjithkund nanen me e lypun m' nepet;
Do t' m' mysë mjerimi, s'kam si gjallnoj,
Pse deka e nanës zemren m' a imtoj. (Mjeda, N., 2002, Vepra letrare, Djali pa nenë si
nata pa henë , fq. 96)*

*Por, ndale vajin, jeto pa droje,
Mendo se drita prap do t' agoje,
Kur nder Qiell t' epra Zoti tash t' thrret:
Rrethue me lule, nana aty t' pret. (Mjeda, N., 2002, Vepra letrare, Djali pa nenë si nata
pa henë , fq. 96)*

*Mos t' ankojm, pse sa t' jet moti,
Per gjithkend do t' mendoje Zoti. (Mjeda, N., Kujdesi Hyjnuer)*

E kryera. -Kuptimi i kësaj kohe të kushtores është të tregojë një veprim që mund të ishte kryer në të shkuarën, po të ishte vërtetuar një kusht i dhënë. E, meqë ky kusht rezulton të mos jetë vërtetuar në të shkuarën, veprimi i emëruar nga e kryera e kushtores gjer në çastin e ligjërimit paraqitet si i paralizuar.

MËNYRA DËSHIRORE

Me anë të kësaj mënyre, shprehet modaliteti i dëshirës në formë urimi ose mallkimi.

Mënyra dëshirore ka dy kohë: të tashmen dhe të kryerën.

Në fjalitë me kuptim mohor para dëshirores vihet pjesëza *mos*.

Tek dëshirorja vihet re, larmi të formave të të dy dialekteve dhe të standardit. Në variantet e dëshirores dallohet ekzistenca e prapashtesave trajtëformuese të dëshirores, përkatësisht e alomorfit – sh(kioshim, kioshit, kioshin), ashtu si në gegërishten veriperëndimore dhe mëgjerë.Po kështu edhe veta e parë dhe e dytë për të dy foljet janë mjaft të zakonshme në kontekste situatave në gegërisht, sikurse folja kam në vetën e tretë shfaq variantin me –ft, kioftë ose vetëm me –t, kiotë.Kjo do parë, ndoshta, jo si veçori e ligjërimeve gege, por si një sprovë e autorit për të sjellë ndonjë afrim me shqipen e shkruar me dialektin geg.



SISTEMI FOLJOR I NDRE MJEDËS

Fitore Imeri,

Koha e tashme.-Kuptimi themelor i kohës së tashme të mënyrës dëshirore është të shprehë dëshirën e folësit, në formë urimi ose mallkimi, për kryerjen e një veprimi në çastin e ligjërimit ose pas tij.

Por e tashmja e dëshirores përdoret edhe për të shprehur veprime të mundshme të së ardhmes, pa shprehur dëshirën e folësit në formë urimi ose mallkimi. Kjo ndodh kur ajo përdoret në fjali të varura kushtore dhe lejore, të ndërtuar me lidhëzën nënrenditëse *në*, përkatësisht *edhe në*. Në një përdorim të tillë ajo është sinonime me të tashmen e lidhore të prirë nga lidhëza nënrenditëse *po*, përkatësisht edhe *po*:

Edhe veta e tretë (aty-këtu edhe veta e dytë) e foljes *jam* në të tashmen e dëshirorës pas përemrave të pacaktuar *kushdo*, *cilido*, *çfarëdo*, dhe pas ndajfoljeve me funksion lidhëzor *kudo e kurdo*, përdoret si sinonime e së tashmes së mënyrës lidhore:

*Ànderr nuk ish : mbí védi,
Pezull prei qiullet, shifshe
Kunorë qi zdrypte, e njifshe
Oren e Austrisë (Mjeda, N., Meyerling)*

E kryera. -E kryera e dëshirorës, ndryshe nga koha e tashme, në kuptimin e saj themelor ka një përdorim tepër të kufizuar, sepse vetëm në raste shumë të veçanta mund të shprehet dëshira e folësit, në formë urimi ose mallkimi, për veprime të së shkuarës. Ajo ndeshet kryesisht në shprehje të tipi: Ju pastë lënë uratën! Na pastë marrë të keqen! Etj.

Rrallë përdoret e kryera e dëshirorës edhe në fjalitë e varura kushtore të ndërtuara me lidhëzën nënrenditëse në; më shumë përdoret në këtë funksion sinonimi i saj, d. m. th e kryera e lidhore e prirë nga lidhëza nënrenditëse kushtore *po*:

MËNYRA URDHËRORE

Kjo mënyrë shfaqet me format e saj në vetën e dytë njëjës dhe shumës në një pjesë rastesh. Duhet thënë se, nëse bëjmë një krahasim me mënyrat e tjera, mund të shohim se sa më shumë modalitet që të shprehë një mënyrë e caktuar, aq më pak forma shfaq ajo.

Nga shembujt që kemi vjelë vihet re një numër të madh nuancash modale të shprehura nga urdhërorja klasike, të cilat përfaqësohen vetëm nga dy forma.

Ky ka qenë koncepti tradicional mbi urdhëroren, por në fakt studimet moderne tregojnë se këto kuptime dalin në struktura dhe modele specifike. Një gjë e tillë është vënë në dukje si nga studimet gjenerative, ashtu dhe nga ato deskriptive. Nga vëzhgimet mund të vëmë re se modaliteti i urdhërores shfaqet mjaft i larmishëm, madje në disa raste mund të flitet për nuanca të kundërta që tradicionalisht shprehen nga e njëjta formë, për këtë arsye duhet të



ishin theksuar projektimet specifike të shoqëruara nga modelet steriotipe, në të cilat shfaqet një nuancë, apo një tjetër.

Dihet në parim se urdhërorja projektohet zakonisht në kontekste situatave specifike, të cilat përgjithësisht janë dialogët, ku dhënësi dhe marrësi janë të pranishëm. Në veprën e Mjedes mënyra urdhërore dhe format përkatëse të saj dalin në rrafshet specifike, jo vetëm në lidhje me elemente dialektore të gegnishtes kështu por në rrafshin semantik ajo na shfaqet me struktura jo thjesht të urdhërores së fortë.

Në veprën e marrë për analizë, format e urdhërores përbëjnë numrin relativisht të vogël në krahasim me format e mënyrave të tjera foljore.

Në fakt kjo është e kuptueshme, po të kemi parasysh makrostrukturën e veprës, e cila përgjithësisht karakterizohet nga ligjërata e zhdrejtë, dhe përkatësisht një stil tregimtar përshkrues.

Përshkrimi i ngjarjeve nga narratori eksplicit (personazhet më pak dhe autori më shumë) ose në vetën e parë, ose të tretë, në shumë pak raste jepet në formën e dialogëve, në të cilat ngjarja mund të shprehet dhe më lirshëm.

Kuptimi i mënyrës urdhërore.-Me anë të kësaj mënyre, shprehet modaliteti i dëshirës në formë urdhri, kërkese, këshille, porosie, luteje, grishjeje, lejimi etj. Në fjalitë me kuptim mohor para urdhërorës vendoset pjesëza e mohimit mos.

Kjo mënyrë forma të vetat ka vetëm për vetën e dytë njëjës e shumës. Kur folësi, nëpërmjet bashkëbiseduesit, dëshiron të urdhërojë një a disa persona, që nuk marrin pjesë në bisedë, atëherë ai përdor me vlerën e urdhërores format e vetës së tretë, njëjës e shumës, të kohës së tashme të lidhore, të prirë ose jo nga pjesëza *le*. Gjithashtu me vlerën e urdhërorës përdoret edhe veta e parë shumës e së tashmes së lidhore në ato raste kur folësi nxit për veprim një grup njerëzish, ku bën pjesë edhe vetë. Me vlerën e urdhërores përdoret nganjëherë edhe e ardhmja e mënyrës dëftore.

Përdorimet kryesore të urdhërores.-Kuptimi kryesor i urdhërores është të shprehë dëshirën e folësit në formë a) urdhri, b) nxitjeje, c) këshille, ç) luteje, d) lejimi etj., për kryerjen e një veprimi në çastin e ligjërit ose pas tij.

Veta e dytë njëjës e urdhërores mund të përdoret për të tri vetat (e njëjësit dhe të shumës), për të paraqitur me një fuqi shprehëse të veçantë një a më shumë veprime të përsëritura në të shkuarën. Kjo ndodh atëherë kur përsëritet urdhërorja e së njëjtës folje, ose kur përdoren format e urdhërores të dy a më shumë foljeve të ndryshme, të shoqëruara secila me kryefjalën përkatëse (e cila mund edhe të nënkuptohet) dhe të lidhura midis tyre me anë të lidhëzës bashkërenditëse e, ose aksidentisht.

*Ty due fjalët me t' i ndigiuë,
As s' kam mend me t' u largue.
Zemren dysh un s' mund e daj:*



M' len t' qindisi, m' len të kja! - (*Mjeda, N., Grueja shqyptare (Amë e bi)*)

Nuanca modale më e zakonshme e shprehur nëpërmjet këtyre rasteve në strukturë, del nuanca e lutjes deri në dëshirim dhe asnjëherë urdhërorja e fortë.

Përgjithsisht përdoret veta e dytë njëjës në formën veprorë.

Natyrisht që e vendosur në skenën ku gjenden zakonisht këto forma të urdhërores përdorime të tilla janë shumë të përshtatshme (kemi parasysh dialogët mes të dashuruarve).

Formalisht më tepër del forma pohore dhe më rrallë ajo mohore dhe në një pjesë të mirë rastesh shoqërohet me trajtat e shkurtra përkatëse.

Përgjithësisht ruhen format foljore të shqipes së sotme me ndonjë ndryshim fonetik, si rasti i përdorimit të mbyllores *g* në vend të aspirantes *h* te folja *hap-gapnie*, apo në vend të ndryshimit fonetik *a-e* del *a-i*, marr-mir. Po kështu edhe *thomnie*. Lut të vij përroit.

Në disa raste trajta e shkurtër shfaqet e përmbysur, si në rastin e foljes *puth* që del në formën *puthëm* në vend të *puthmë* që e gjejmë në shqipen e sotme.

Përveçse në fund të temës, trajta e shkurtër shfaqet dhe në trup të saj, pozicionim i njohur ky edhe në gjuhën shqipe. Një rast i tillë shfaqet te folja them, përkatësisht *thomnie*.

Vetëm në një rast një folje del në variantin italisht përkatësisht *ngre/via*.

Duhet të shtojmë se modalitetin e urdhërores e gjejmë dhe te mënyrat e tjera si lidhorja në strukturë me folje të tjera si ato modale, apo dhe të tjera (lutje, përgjërime etj.)

PËRFUNDIMI

Nga parashtrimet, analizat dhe krahasimet e sistemit foljor të Mjedës, mbështetur kryesisht në “Juvenilja”, si dhe të tjerat të votuara të përbledhura në, 1999, Juvenilja dhe vjersha të tjera, 2002, Vepra letrare, mund të nxjerrim këto përfundime të përgjithshme:

Sistemi foljor i përdorur prej Mjedës, përgjithësisht nuk ndryshon nga ajo gegnishtes.

Në sistemin foljor të gjuhës së De Radës, tek veprat, mënyra dëftore ka korpusin më të madh të foljeve që përdoren në poemë (rreth 730 raste). Kjo mënyrë paraqitet me një shumëllojshmëri formash, nëpërmjet së cilave shprehen dallime kuptimore me karakter kohor dhe aspektor. **Koha e tashme** në formën veprorë në foljet e zgjedhimin e parë dhe të dytë gjejmë të ruajtur mbaresën e vjetër - *nj*- (Më mirë të themi dhe të kombinuar me elemente të tjera, jo në të gjitha rastet vetëm.): v. I *-(ë)nj*, v. II *-(ë)n*, v. III *-(ë)n*; shumës: v. I *-(ë)mi/(ë)njëmi/ëm*, v. II *-ni/ ënjëni/ëni*, v. III *-njën/ (ë)njën/ën*.

Foljet e zgjedhimit të tretë në tre vetat e para marrin mbaresë zero, si në shqipen e sotme. Në vetat e shumës dalin me mbaresat *-më*, *-ni*, *-në* (*pra mund të themi se kemi të njëjtat forma me të sotmet*).



Në formën joveprore pavarësisht ndryshimeve tematike të caktuara, mbaresat e foljeve shfaqen të njëjta si sot: v. I *-(h)em*, v. II *-(h)e*, v. III *-(h)et*; shumës: v. I *-(h)emi*(, v. II *-(h)eni* v. III *-(h)en*.

Koha e pakryer del: me një trajtë të thjeshtë, mbaresat e së cilës, në pjesën më të madhe janë të njëjta ose afrojnë me ato të folmeve më arkaike të skajit jugor. Për dy vetat e para të njëjësit dhe për tri vetat e shumësit mbaresat e së pakryerës (për foljet e trajtës veprore) janë të njëjta si për foljet me zanore ashtu edhe për ato me bashkëtingëllore: v. I *-(ë)nja*, v. II *-(ë)nje*, shumës: v. I *-njim*, v. II *-njit*, v. III *-njin*, ndërsa në vetën e tretë njëjës gjendja është disaformëshe: me mbaresën *-nej* p.sh. ljanëj “lante” -ij p.sh. *ljëij*“linte”, pa mbaresë p.sh. *prit* “priste”, *vej* “vente” etj. Për ta kthjelluar gjendjen e kësaj trajte po japim paradigmen e disa foljeve kryesore:

Në formën joveprore vëmë re shfaqjen e alomorfit të sotëm *-hesha/ësha*, *heshe/ëshe*, *he/ej*, *heshim/ëshim*, *hëshit/ëshit*, *hëshin/ëshin* me ndonjë ndryshim në foljet e zgjedhimit të dytë në vetën e dytë dhe të tretë shumës, ku reflektohet ndryshimi i ë-së në e, ndryshe nga shqipja e sotme, si një variant dialektor.

LITERATURA

- Gramatika e Gjuhës Shqipe 1, Botim i Akademsë së Shkencave, Tiranë
- Çabej.E, Studime gjuhësore (I-IV), Rilindja, Prishtinë, 1976.
- Demiraj. Sh “ Gramatikë historike e gjuhës shqipe”, 8 Nëntori, Tiranë 1986
- Demiraj. SH, Kuptimet e kohëve të mënyrës dëftore në gjuhën shqipe, SF, Tiranë, 1971
- Demiraj. SH, Morfologjia e gjuhës shqipe II, Tiranë, 1963.
- Gjinari J., Dialektet e gjuhës shqipe, Akademia e Shkencave e RPS të Shqipërisë, Instituti i Gjuhësisë dhe i Letërsisë, Tiranë, 1989.
- Kostallari.A, Kompozitat dëshirore dhe urdhësirore dhe urdhërore të shqipes, në “Studime mbi leksikon e mbi formimin e fjalëve në gjuhën shqipe”, I, Tiranë”, I, Tiranë 1972.
- Likaj. E, Mbi zhvillimin e disa formave gramatikore, SF 1977
- Likaj.E, “Format analitike në gjuhën shqipe”,SHBLU, Tiranë, 1997.
- Lyons.J, “Hyrtje në Gjuhësinë Teorike”, Dituria, Tiranë, 2001.
- Memisha.V, Studime për fjalën shqipe, Botart, Tiranën shqipe, Botart, Tiranë 2011.
- Memushaj. R. “ Rreth lëvizjeve në sistemin foljor të shqipes” , Tiranë, 1996.
- Mjeda, N., 1999, Juvenilja dhe vjersha të tjera, Shtëpia Botuese Dituria, Tiranë
- Mjeda, N., 2002, Vepra letrare, Shtëpia Botuese UEGEN, Tiranë.
- Mjeda, N., Bukuri e virtyt



SISTEMI FOLJOR I NDRE MJEDËS

Fitore Imeri,

- Mjeda, N., Fuqija e uratës
- Mjeda, N., Grueja shqyptare (Amë e bi)
- Mjeda, N., Meyerling
- Mjeda, N., Shqypni e s' ke! Shqyptari e Bylbyli
- Mjeda, N., Kujdesi Hyjnuer
- Topalli. K., “Gramatikë historike e gjuhës shqipe”, Kristalina, Tiranë, 2010.
- Topalli. K., “Sistemi Foljor i Gjuhës Shqipe”, Plejad, Tiranë 2010.